



## PAKETA FISKALE 2020

Buletini informativ i përgatitur nga ekspertët e Mazars sjell një përmbledhje të ndryshimeve më të rëndësishme ligjore të përfshira në paketën fiskale 2020 në Shqipëri.

---

*Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*

**Paketa fiskale parashikon shtesat e mëposhtme:**

- **Kompensimi i detyrimeve tatimore dhe doganore**  
Detyrimet dhe tepricat kreditore tatimore dhe doganore do të mund të kompensohen ndërmjet tyre, ne raste të veçanta, pavarësisht se ndodhen nën juridiksionin e dy institucioneve të ndryshme. Specifikat e aplikimit në praktikë do të përcaktohen me udhëzim të Ministrisë së Financave.
- **Rimbursimi i TVSH-së**  
Rimbursimi i TVSH-së së miratuar mund të kryhet nëpërmjet pagesës me këste, nëse arrihet dakordësia midis administratës tatimore dhe tatimpaguesit. Pavarësisht modalitetit të pagesës, detyrimi do të konsiderohet i shlyer në kohë dhe mbi të nuk do të aplikohen kamatvonesa.

# Tax Alert

- **Deklarimi si i pambledhshëm i detyrimit tatimor**  
Administrata tatimore ngre komisione të posaçme për shqyrtimin e kushteve për deklarimin si të pambledhshëm të detyrimit tatimor. Deklarimi si i pambledhshëm i detyrimit tatimor do të pershkallëzohet si më poshtë:
  1. Për shuma deri në 1.000.000 lekë deklarimi kryhet nga Drejtoria Rajonale Tatimore;
  2. Për shuma nga 1.000.000 deri në 5.000.000 lekë deklarimi kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
  3. Për shuma mbi 5.000.000 lekë deklarimi kryhet nga Ministri i Financave.
- **Mbledhja e detyrimeve me forcë**  
Drejtoritë e posaçme të mbledhjes së detyrimeve me forcë, pranë drejtorive rajonale, do të kalojnë nën varësine direkte të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

## **Paketa fiskale parashikon ndryshimet e mëposhtme:**

- **Kontrollet në terren pa njoftim paraprak**  
Ndryshimet ligjore të paketës fiskale kanë legjitimuar të drejtën e administratës tatimore për të kryer kontrollet e mëposhtme pa njoftim paraprak:
  1. Regjistrimi i personave të tatueshem;
  2. Përdorimi i pajisjeve fiskale;
  3. Dokumentimi i mallrave për ruajtje, përdorim dhe transport;
  4. Dokumentimi i çdo transaksioni të shitjes së mallrave apo shërbimeve;
  5. Regjistrimi i punonjësve.
- **Personat e papaguar të familjes të identifikuar pranë “të vetëpunësuarit”**  
Nëse administrata tatimore gjatë kontrollit pranë subjektit konstaton persona mbi 16 vjeç të padeklaruar si persona të papaguar të familjes, barra e provës për të vërtetuar lidhjen familjare i kalon administratës tatimore. Përpara ndryshimit në fjalë, barra e provës për të treguar lidhjen familjare i përkiste tatimpaguesit.
- **Sanksionet për shkelje të procedurave tatimore**  
Kanë pësuar ndryshime sanksionet e aplikuar për mosrespektimin e procedurave të përcaktuara në rastin e transaksioneve të mëposhtme tatimore:
  1. Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore;
  2. Mosregjistrimi i të dhënave të subjekteve që leshojnë fatura;
  3. Moslëshimi i faturave dhe faturave shoqëruese; dhe
  4. Mosmarrja e faturave të lëshuara.

Sanksionet e vendosura, në ndryshim nga sa më parë, konsistojnë në gjoba, niveli i të cilave varion nga 1,000- 75.000 lekë.

Shtesat dhe ndryshimet e mësipërmë hyjnë në fuqi nga data 15 janar 2020.

**Burimi:** Ligji nr.83/2019, datë 30 dhjetor 2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për Proceduarat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”; Fletorja Zyrtare nr. 184, datë 31 dhjetor 2019.

**Shënim:** Ligji i cituar ka pësuar një sërë ndryshimesh të tjera të lidhura me Ligjin “Për Faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, për të cilën ekspertët tanë po përgatisin një buletin informativ të dedikuar.

#### **Paketa fiskale parashikon shtesat e mëposhtme:**

- **Përrjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat personale kalimi i pronësisë brenda familjes nëpërmjet dhurimit apo heqjes dorë**  
Përrjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat personale kalimi i së drejtës së pronësisë, brenda lidhjes gjinore në familje, (bashkëshort, bashkëshorte, fëmijë), vetëm një herë ndaj një përfituesi, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria.
- **Tatimi i personave të dypunësuar nëpërmjet deklaratës vjetore**  
Personat e dypunësuar do të përdorin deklaratën individuale vjetore si mënyrë për deklarimin dhe tatimin e të ardhurave të përftuara nga punësimi në subjekte të ndryshme. Kushti i të ardhurave individuale prej 2 milion lekësh nuk është më i aplikueshëm në rastin e individëve të dypunësuar.
- **Rritet në 3% niveli i njohjes së shpenzimeve të përfaqësimit për shoqëritë eksportuese**  
Për tatimpaguesit eksportues, të cilët gjatë 3 viteve të fundit mbi 70% të të ardhurave e kanë realizuar nga eksportet, shpenzimet e dokumentuara, të kryera për pjesëmarrje, prezantim në panairë apo ekspozita jashtë vendit, njihen si shpenzime të zbritshme deri në masën 3% të xhiros vjetor. Nuk përftojnë nga ky ndryshim shoqëritë e industrisë fasone.
- **Përrjashtime nga ndjekja e procedurave për ndryshimin e pronësisë**  
Procedurat e përcaktuara në nenin 27/1 "Ndryshimi i pronësisë", nuk do të zbatohen në rastet kur ndryshimi i pronësisë së kapitalit aksionar, kuotave, ose e të drejtave të votimit i nënshtrohet dispozitave të marëveshjeve të ratifikuara për shmangien e tatimit të dyfishtë në fuqi. Kujtojmë që ky ndryshim hyri në fuqi në janar 2019.

#### **Paketa fiskale parashikon ndryshimet e mëposhtme:**

- **Norma e tatim fitimit për industrinë automotive reduktohet në 5%**  
Për personat juridik që ushtrojnë aktivitet në industrinë automotive, shkalla tatimore e tatim fitimit bëhet 5%. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim aktivitetet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike.
- **Ndryshon afati i mbartjes së humbjeve për kategori ta caktuara tatimpaguesish**  
Tatimpaguesit, që investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliard lekë, mund të mbartin humbjen e realizuar gjatë një periudhe tatimore deri në pesë (5) periudhat e ardhshme. Rregulli i përgjithshëm i mbarjes së humbjeve është deri në tre (3) periudha tatimore.

- **Incentiva fiskale për sponsorizimet e veprimtarive sportive**

Sponsorizimet e veprimtarive të ekipeve sportive, të kryera nga tatimpaguesit të cilët realizojnë një fitim vjetor të tatueshem mbi 100 milion lek, janë shpenzime te njohura për efekte fiskale deri në masën e tre-fishit të vlerës së sponsorizuar. Në asnjë rast nuk lejohet mbartja e këtyre shpenzimeve në periudhat pasardhëse.

Në mënyrë që të përftojnë nga ndryshimi në fjalë, tatimpaguesit duhet të pajisen me autorizim të posaçëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe të kryejnë sponsorizimet në përputhje me Ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", të ndryshuar.

Shtesat dhe ndryshimet e mësipërmë hyjnë në fuqi nga data 15 janar 2020.

**Burimi:** Ligji nr.84/2019, datë 30 dhjetor 2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", të ndryshuar"; Fletorja Zyrtare nr. 184, datë 31 dhjetor 2019.

*Ligji Nr.92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar*

**Paketa fiskale parashikon shtesat e mëposhtme:**

- **Shtohet lista e furnizimeve me shkallë të reduktuar të TVSH-së**  
Aplikohet shkalla e reduktuar e TVSH-së prej 6% në furnizimin e mjeteve me motor elektrik, të përdorura për transportin publik të licensuar të udhëtarëve me nëntë vende plus.
- **Shtohet lista e furnizimeve të përjashtuara të TVSH-së**  
Furnizimet e mëposhtme shtohen në listen e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja:
  1. Furnizimi i procesit të ndërtimit nga ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda programit të rindërtimit, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
  2. Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave i kryer direkt për ndërtuesit subjekte të rindërtimit, brenda programit të rindërtimit, të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve; dhe
  3. Importi i materialeve, pajisjeve, ndërtesave të parafabrikuara, të importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore, organizatat bamirëse dhe filantropike për rastet e shpalljes së "gjendjes së fatkeqësisë natyrore", brenda programit të rindërtimit.

Procedurat dhe mënyra e zbatimit të sa më sipër do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- 4. Furnizimi i automjeteve të reja me motor elektrik, të cilët nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër.

**Paketa fiskale parashikon ndryshimet e mëposhtme:**

- **Momenti i lëshimit të auto-faturës (reverse – charge)**  
Në rastin e shërbimeve të marra nga furnitor të huaj, për të cilët aplikohet skema e auto-faturimit (reverse charge), tatimpaguesi shqiptar duhet të lëshojë auto-faturën brenda datës 10 të muajit pasardhës. Përpara ndryshimit, afati i lëshimit në fjalë ka qenë data 14 e muajit pasardhës.

Shtesat dhe ndryshimet e mësipërmë hyjnë në fuqi nga data 15 janar 2020.

**Burimi:** Ligji nr.92/2019, datë 30 dhjetor 2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; Fletorja Zyrtare nr. 184, datë 31 dhjetor 2019.

**Shënim:** Ligji i cituar ka pësuar një sërë ndryshimesh të tjera në lidhje me procesin e faturimit dhe momentin e faturimit të lidhura me Ligjin "Për Faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", për të cilën ekspertët tanë po përgatisin një buletin informativ të dedikuar.

*Ligji nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar*

**Paketa fiskale parashikon shtesat e mëposhtme:**

- **Specifikime për automjetet e klasifikuara si "Automjete luksoze"**  
Për klasifikimin e mjetit si "Automjet luksoz", vlera e mjetit amortizohet çdo vit me 10 % të vlerës së mbetur. Për automjetet të cilat shiten, vlera e shitjes së tyre, për efekt klasifikimi si "Automjet luksoz", nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar sipas metodës së mësipërme.

**Paketa fiskale parashikon ndryshimet e mëposhtme:**

- **Ndryshon mënyra e llogaritjes së nivelit të gjobave të taksës vjetore të automjeteve**  
Llogaritja e gjobës për mospagesën në kohë të taksës vjetore të automjeteve ndryshon nga 5% të detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, (por jo më shumë se 25% në vit) në 0.06% të detyrimit të papaguar për çdo ditë vonesë, (por asnjëherë nuk llogaritet më shumë se 365 ditë).

Shtesat dhe ndryshimet e mësipërmë hyjnë në fuqi nga data 15 janar 2020.

**Burimi:** Ligji nr.86/2019, datë 30 dhjetor 2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar; Fletorja Zyrtare nr. 184, datë 31 dhjetor 2019.

## KONTAKT

### MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje për çështjet e mësipërme apo të tjera në lëmin fiskal, ju lutem drejtohuni:

#### Teit GJINI

Managing Partner  
teit.gjini@mazars.al

#### Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services  
erinda.xhaferraj@mazars.al

#### Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889  
E-mail: info@mazars.al